



DIGJITALIZIMI NË SHKOLLAT NË KOSOVË

RAPORTI I PILOTIMIT
TË INDIKATORËVE TË
PERFORMANCËS SË
SHKOLLAVE
INDIKATORI I DIGJITALIZIMIT



DIGJITALIZIMI NË SHKOLLAT NË KOSOVË

RAPORTI I PILOTIMIT
TË INDIKATORËVE TË
PERFORMANCËS SË
SHKOLLAVE

INDIKATORI I DIGJITALIZIMIT

Raporti i pilotimit të Indikatorëve të performancës së shkollave – Indikator i Digjitalizimit

Raporti – digjitalizimi i shkollave në Kosovë shpalos të gjeturat nga vlerësimi i 99 shkollave në 28 komuna të Kosovës gjatë muajit dhjetor të vitit 2020 me qëllim të pilotimit të indikatorit të digjitalizimit si përgatitje për fazën e ardhshme të vlerësimit të performancës së shkollave gjatë vitit 2021_2022 në Kosovë. Siç vërehet në figurën1, indikator i digjitalizimit është pilotuar me shkollat kryesisht jashtë rajonit të Prishtinës, dhe edhe pse nuk paraqet mostër reprezentative, qëllimi kryesor ka qenë të ndihmoj validimin e indikatorit para se të përdoret në një mostër reprezentative në 615 shkolla në Kosovë.



Figura 1. Numri i shkollave nëpër Komuna që kanë qenë pjesë e pilotimit

Indikatori i Digjitalizimit dhe Metoda e vlerësimit

Indikatori i digjitalizimit është njëri nga shtatë indikatorët për vlerësimin e performancës së shkollave dhe ai mbulon pesë kategori kryesore si: strategjia e digjitalizimit në nivel shkolle, qasja e internetit, pajisjet digjitale dhe kabinetet informatike, menaxhimi e informatave dhe komunikimi dhe shërbimet teknike dhe bibliotekare.


Vlerësimi përfshin observimet e hulumtuesve dhe praktikën e verifikimit të fakteve duke administruar një pyetësor fizikisht në shkollë, observimin e shkollës, infrastrukturës dhe mbledhjen e fakteve dhe analizimin e dokumenteve.

Pyetjet/nënkategoritë që përfshihen në secilën kategori kanë 5 opsione të cilat zgjidhen nga një rubrikë e përgjigjeve ose deklaratave të cilat shprehen në përqindje dhe rangim prej numrit 1 deri në 5. Për secilën kategori kalkullohet mesatarja aritmetike që përfshin të gjitha pyetjet/nënkategoritë. Përqindjet fillojnë nga 50-100 me konsideratën ky lloj vlerësimi merr parasysh se akterët e ndryshëm të përfshirë ndajnë përgjegjësi të ndryshme lidhur me përmbushjen e aspektve që mbulohen dhe duke njohur mundësinë e problemeve sistemike në nivel komune jashtë kontrollit të shkollës. Duke pasur parasysh që fokusi i këtij projekti qëndron në identifikimin e problemeve dhe përmirësimin e tyre rangimi fillon nga 1 deri në 5 siç paraqitet në tabelën 2.

Cilat hapësira në shkollë kanë internet?	Përqindja	Vlerësimi
Të gjitha hapësirat e shkollës kanë internet	81-100	5
Zyra e Drejtorit dhe Kabineti i Teknologjisë	71-80	4
Vetëm Kabineti i Teknologjisë	61-70	3
Vetëm Zyra e Drejtorit	51-60	2
Asnjë, shkolla jonë nuk ka qasje në internet	0-50	1

Rangimi i përgjithshëm

Nga analiza e të dhënave të mbledhura nga shkollat të përfshira në këtë fazë të pilotimit, kemi një performancë të përgjithshme për digjitalizim të cilën e kemi vlerësuar me 3.19 kurse më specifikisht për kategoritë kryesore kemi rangimin si në vijim: 3.4 për strategjinë digjitale dhe menaxhimin, 3.4 për qasjen në internet, 1.78 për pajisjet digjitale, 3.25 për informimin dhe komunikimin, dhe 3.9 për mbështetja teknike dhe biblioteka.



Prej nënkategorive ato që janë vlerësuar më së larti janë mbështetja teknike dhe Plani i digjitalizimit kurse më së ulti numri i kompjuterëve në shkollë dhe numri i pajisjeve që ju janë dhënë nxënësve për mësim nga distanca.




Figura 2. Rangimi i nënkategorive

Strategjia digjitale dhe Menaxhimi i shkolles (Vlerësimi 3.4)

Për sa i përket strategjisë digjitale dhe menaxhimit, figura 3 tregon rangimin për nënkategoritë me rangimet si në vijim: Buxheti për dixhitalizim 2.9, Digjitalizmi në Planin Zhvillimor të Shkollës 4.4, Menaxhimi i të dhënave në SMIA 3.9 dhe Menaxhimi dhe shfrytëzimi i pajisjeve 2.7.




Figura 3. Vlerësimi i kategorisë Strategjia Digjitale dhe Menaxhimi

Nga analiza më e detajuar rezulton që 56.56% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit s'kanë fare buxhet për dixhitalizim, 23.23% të shkollave kanë një buxhet vjetorë për digjitalizim, 11.11% të shkollave kanë një buxhet të limituar për një deri në dy pajisje, 5.5% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë një buxhet të cilin nuk e kanë zbatuar dhe 4.4% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë hulumtimit nuk janë të informuar mbi buxhetin për digjitalizim.

Për sa i përket planit për dixhitalizim në Planin Zhvillimor të Shkollës, 58.58% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit e kanë pjesë të planit zhvillimor digjitalizimin dhe kanë marrë masa konkrete për realizimin e tij, 31.31% të shkollave e kanë pjesë të planit zhvillimor digjitalizimin por nuk kishin marrë ende masa konkrete në kohën e intervistimit, 6.6% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë hulumtimit kanë pohuar se digjitalizimi është pjesë e planit zhvillimor, mirëpo vetëm sipërfaqësisht dhe 3.3% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit nuk e kanë digjitalizimin si pjesë e planit zhvillimor. Prej kësaj vërehet se përderisa planet mund të përfshijnë objektiva për digjitalizim, më shumë punë duhet të bëhet për zbatimin dhe monitorimin e këtyre planeve.

Hulumtimi po ashtu ka synuar të vlerësojë mënyrën se si inkuadrohen të dhënat në sistemin për menaxhim të informacionit të MASHT SMIA. Rezultatet tregojnë se 53.53% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit deklarojnë se futjen e të dhënave e bën vetëm drejtori, 19.19% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit deklarojnë se futjen e të dhënave e bën vetëm sekretari, 23.23% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë hulumtimit deklarojnë se futjen e të dhënave e bëjnë në mënyrë të përbashkët Drejtori, Sekretari, Koordinatori i Cilësisë dhe zyrtari i IT, 3.3% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit deklarojnë se futjen e të dhënave e bën personi përgjegjës në fushën e IT, 1.1% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit deklarojnë se futjen e të dhënave e bën koordinatori i cilësisë. Lidhur me këtë, sugjerohet të zgjerohet pyetje lidhur me shfrytëzimin e këtyre të dhënave për vendimmarrje.

Për sa i përket vlerësimit për kapacitetin e institucioneve për të menaxhuar dhe përdorur pajisjet që i posedojnë, 21.21% të shkollave nuk janë në dijeni se sa prej pajisjeve përdoren plotësisht, 24.24% të shkollave përdorin plotësisht me pak se 50% të pajisjeve, 26.26% të shkollave përdorin plotësisht rreth 50% deri në 75% të pajisjeve, 17.17% të shkollave përdorin plotësisht rreth 76% deri në 90% të pajisjeve dhe 11.11% të shkollave përdorin plotësisht me shume se 90% të pajisjeve. Në këtë aspekt vërehet një nevojë për regjistrim, monitorim dhe përdorim më efikas të pajisjeve që kanë në dispozicion shkollat.

INTERNETI (Vlerësimi 3)

Për sa i përket kategorisë interneti figura 4 tregon rangimin për nënkategoritë me vlerësimin si në vijim: Lloji i internetit 3.3, shpejtësia e internetit 2.3, shpërndarja e internetit 3.6.




Figura 4. Vlerësimi i kategorisë Interneti


Përderisa Kosova njihet për një penetrim të gjerë të internetit në tërë territorin e Kosovës, 55.55% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë deklaruar se kanë internet me kablo, 25.25% të shkollave kanë Wireless, 8.8% të shkollave kanë internet me fibër optike, 4.4% të shkollave kanë deklaruar se kanë internet të tipit ADSL dhe 7.7% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit nuk kanë fare qasje në internet. Verifikimi i këtyre të dhënave ka qenë më i vështirë për shkak të mungesës së qasjes në kontrata dhe njohurive teknike të cilat kanë pasur në posedim shkollat, ku për shembull qasja me ADSL nuk përdoret në Kosovë që një kohë të gjatë, dhe për monitorimin e radhës, do të saktësohet mënyra e verifikimit të fakteve për këtë nënkategori dhe shpjegimit të tyre për shkolla.

Për sa i përket shpërndarjes internetit në shkollë, 37.37% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë internet në të gjithë shkollën. 29.29% të shkollave kanë internet vetëm në zyrën e drejtorit dhe kabinetin e teknologjisë, 1.1% të shkollave kanë internet vetëm në kabinetin e teknologjisë, 25% të shkollave kanë internet vetëm në zyrën e drejtorit, dhe 7.7% të shkollave nuk kanë fare qasje në internet.

Për sa i përket shpejtësisë së internetit, shkollave ju mungon informacioni teknik i sigurtë lidhur me këtë, ku sipas raportimit 41.41% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit nuk janë në dijeni për shpejtësinë e internetit që e posedojnë, 11.11% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë internet me shpejtësi prej 2mbps deri më pak se 5mbps., 25.25% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë internet 5mbps deri më pak se 10mbps. 18.18% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë internet 10mbps deri më pak se 100mbps dhe 5.5% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë internet me më shumë se 100mbps.

PAISJET DIGJITALE (Vlerësimi 1.78)

Nënkategoria Pajisjet digjitale ka vlerësimin më të ulët ku vlerësimi për katër nënkategori është si në vijim : Kabinetet e kompjuterëve 1.6, Kompjuterët ne shkolle1.8, Llaptoptet në shkolle1.15, Projektorët ne shkolle 2.18 dhe Pajisjet online të dorëzuara tek nxënësit gjatë pandemisë 2.2.



Për sa i përket pajisjes së shkollës me kabinet të TIK, 20.20% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit nuk kanë fare kabinet të kompjuterëve, 72.72% të shkollave kanë vetëm një kabinet të kompjuterëve, 5.5% të shkollave kanë 2 kabinate të kompjuterëve dhe 1.1% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë 3 kabinate të kompjuterëve, 1.1% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë 4 deri në 5 kabinate të kompjuterëve. Në hulumtimin e radhës rangimi do të marrë përsipër edhe raportin e pajisjeve për studentë për të bërë një vlerësim më real.

Për sa i përket përdorimit të kompjuterëve, 88.88% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë 0-20 kompjuterë që përdoren nga nxënësit, 8.8% të shkollave kanë 21-40 kompjuterë që përdoren nga nxënësit, 2.2% të shkollave kanë 41-60 kompjuterë që përdoren nga nxënësit dhe 1.1% të shkollave kanë 61-80 kompjuterë që përdoren nga nxënësit.


Përsa i përket lloptopëve që përdoren nga mësime dhënësit, 3.23% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit nuk kanë asnjë laptop për përdorimin e mësime dhënësit, 56.56% të shkollave kanë 2-4 laptop për përdorimin e mësime dhënësit. 6.6% të shkollave kanë 5-9 laptop për përdorimin e mësime dhënësit, 7.7% të shkollave kanë 11-15 laptop për përdorimin e mësime dhënësit dhe 7.7% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë 16-20 laptop për përdorimin e mësime dhënësit. Në hulumtimin e ardhshëm do të merren parasysh edhe raportin e pajisjeve për mësime dhënësit për të bërë një vlerësim më të saktë për këtë nënkategori.

Shkollat poashtu nuk janë të pajisur me shumë projektorë, ku 10.10% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit s'kanë asnjë projektorë në shkollë, 66.66% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë 2-4 projektorë në shkollë, 15.15% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë 5-9 projektorë në shkollë, 5.5% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë 11-15 projektorë në shkollë dhe 3.3% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë 16-20 projektorë në shkollë. Edhe ky indikator do të marrë parasysh raportin e projektorëve për klasa për të matur më saktë këtë indikator.

Për sa i përket shpërndarjes së pajisjeve të nxënësit për mësim online, 56.56% % të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit deklarojnë se nuk kanë dhuruar asnjë pajisje për mësim online, 32.32% të shkollave deklarojnë se kanë dhuruar 2-4 pajisje për mësim online, 6.6% të shkollave deklarojnë se kanë dhuruar 5-9 pajisje për mësim online, 2.2% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit deklarojnë se kanë dhuruar 11-15 pajisje për mësim online dhe 3.3% të shkollave deklarojnë se kanë dhuruar 16-20 pajisje për mësim online. Në kuadër të këtij indikator nuk është vlerësuar cilësia e pajisjeve, kurse mesazet e pajisjeve për kokë nxënësi do të llogariten në fazën e mëtutjeshme të projektit kur verifikohen të dhënat demografike.

INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI (Vlerësimi 3.25)

Kjo kategori synon të vlerësojë mënyrat digjitale të komunikimit dhe informimit ku nënkategoria emaili zyrtar i shkollës është vlerësuar më 3.6, dhe websajti për shkollën është vlerësuar më 2.9.




Për sa i përket komunikimit zyrtar, 16.16% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit nuk kanë email zyrtar të shkollës, 18.18% të shkollave kanë email adresa të shkollës për më shumë se 50% të mesimdhënësve dhe nxënësve, 35.35% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë email adresa të shkollës për më shumë se 90% deri 100% të mesimdhënësve dhe nxënësve, 26.26% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë email adresa për drejtorin e shkollës dhe info dhe 4.4% të shkollave nuk janë të informuar rreth emailve që posedon shkolla. Verifikimi i këtij indikator poashtu ka hasur në probleme dhe ky raport përfshin deklaratat zyrtare të shkollave. Sugjerohet që në hulumtimin gjithëpërfshirës të verifikohen abonimet për të matur më mirë këtë nënkategori.

Shkollat në shumicën e rasteve komunikojnë përmes facebook. Më specifikisht, 16.16% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit s'kanë fare website të shkollës, 65.65% të shkollave posedojnë faqe në rrjete sociale, 9.9% të shkollave kanë ëebsite të shkollës të qasshëm nga publiku, 5.5% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit kanë një webfaqe të shkollës në Google site dhe 4.4% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit nuk janë të informuar rreth websajtit të shkollës.

MBESHTETJA TEKNIKE DHE BIBLOTEKA (Vleresimi 3.9)

Kjo kategori synon të vlerësojë mbështetjen teknike, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe funksionimin e bibliotekave. Ku bibliotekat janë vlerësuar me 3.5, përdorimi i platformave online 4.7, dhe mirëmbajtja e pajisjeve me 3.5.



Më specifikisht, 10.1% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e e hulumtimit nuk kanë fare bibliotekë, 4% të shkollave kanë një kënd të librave në kabinetin e informatikës, 68.68% të shkollave kanë një klasë në posaqme për bibliotekë dhe 17.17% të shkollave kanë një kënd në shkollë që përdoret si bibliotekë. Edhe pse vlerësimi për këtë nënkategori është 3.5 të dhënat tregojnë që shkollat ende nuk janë të pajisuara me biblioteka moderne, gjë që në të ardhmen ky indikator mund të ndryshohet nëse standardi për biblioteka shkollore përmirësohet nga autoritetet arsimore.

Për sa i përket sistemit për menaxhimin e mësimin ose platformave online (LMS), 19.19% të shkollave përdorin Google Classroom, 9.9% të shkollave përdorin Microsoft Teams, 25.25% të shkollave përdorin MIS të integruar (menaxhim, administratë, përmbajtje, mësim, vlerësim, analizë), 5.5% të shkollave përdorin një sistem virtual dhe 41.41% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë hulumtimit pohojnë që kanë një sistem për menaxhimin e informacionit duke iu referuar SMIA. Edhe kjo nënkategori ka qenë vështirë të verifikohet me rastin e pilotimit, ku rekomandohet që mënyra e verifikimit të përmirësohet në të ardhmen për të na dhënë një pasqyrë më të saktë.

Për sa i përket mirëmbajtjes së pajisjeve TIK, 4.4% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e e hulumtimit deklarojnë se askush nuk mirret me mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK, 9.9% të shkollave deklarojnë se një kompani e jashtme e kontraktuar nga shkolla mirret me mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK, 86.86% të shkollave të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit deklarojnë se Staf i shkollës (mësimdhënësit ose stafi me njohuri rreth TI) mirret me mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK. Edhe pse vlerësimi në këtë kategori është menduar të vlerësojë më lartë kapacitetin e shkollës, hulumtimi ka treguar se shkollat nuk kanë një person të vëçantë teknik që merret me zbatimin e digjitalizimit në shkollë, duke lënë këtë detyrë kryesisht mësimdhënësve të TIK.

Konkluzionet dhe Rekomandimet

Indikatori i digjitalizimit jep një pasqyrë të nivelit të digjitalizimit në shkolla dhe mund të përdoret për të monitoruar këtë indikator në nivel vendi. Lista e dokumenteve që duhet të sigurohet për verifikimin e fakteve duhet të përmirësohet sidomos për llojin, shpejtësinë e internetit, llojin dhe cilësinë e pajisjeve, dhe përdorimin e pajisjeve si dhe llojin e MIS dhe MLS. Të dhënat demografike në shkolla mund të përdoren për të vlerësuar raportin e numrit të kabineteve dhe pajisjeve për studentë dhe raportin e projektorëve dhe llaptopëve për klasë/mësimdhënës. Raportimi për shkollë dhe komunë do të japin edhe një pasqyrim më të qartë për nivelin dhe përpjekjet për digjitalizim nga shkolla dhe komuna.

DIGJITALIZIMI NË SHKOLLAT NË KOSOVË

RAPORTI I PILOTIMIT
TË INDIKATORËVE TË
PERFORMANCËS SË
SHKOLLAVE

INDIKATORI I DIGJITALIZIMIT